



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 102
Prishtinë, më 11 mars 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 MARS 2010**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Etem Arifi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqit deputeti Gani Geci.

Deputeti **Gani Geci**, duke përkujtuar përvjetorin e 21-të të grevës së minatorëve të “Trepçës”, shënuar para pak ditësh dhe kontributin e tyre në rrjedhat e gjithmbarshme të zhvillimeve në Kosovë, kërkoi nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës trajtimin adekuat të asaj kategorie të minatorëve, e cila është para pensionimit, por që akoma nuk i kanë mbushur 65 vjet.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** lidhur me këtë çështje njoftoi Kuvendin se pikërisht sot është biseduar në Qeveri me një delegacion të këtyre minatorëve dhe shfaqti zotimin se Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i dalë në ndihmë kësaj kategorie të minatorëve.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi në vazhdim i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 25 mars 2010,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-28 për procedurën administrative,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar,
7. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 25 shkurt 2010

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 25 shkurt 2010, **u miratua pa vërejtje.**

Deputeti **Driton Tali dhe Riza Smaka** bënë vërejtje në transkriptin e dt. 25 shkurt 2010.

Kryetari kërkoi që vërejtjet e deputetëve ne tekstin e transkriptit t'i dërgohen me shkrim Administratës së Kuvendit, për përmirësim.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Sanije Aliaj** parashtroi pyetje për ministrin **Enver Hoxhaj** lidhur me lejin e zhvillimit të procesit mësimor të komunitetit goran në Kosovë me plan-programet e Serbisë.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes se deputetes Aliaj.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministren **Justina Shiroka – Pula** lidhur me atë se kush është drejtor ekzekutiv dhe kush e përbën bordin e kompanisë kosovare për distribucion dhe furnizim me energji elektrike.

Ministrja Shiroka -Pula iu përgjigj pyetjes se deputetit Tali.

Deputeti **Bujar Dugolli** parashtroi pyetje për ministrin **Lutfi Zharku** lidhur me masat e ndërmarra nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për evitimin e pengimit të zbatimit të

marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA, që po i bën Republika e Serbisë dhe Republika e Bosnjë Hercegovinës.

Ministri Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Dugolli.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtoi pyetje për ministrin **Zenun Pajaziti** lidhur me atë se a janë vjedhur dëshmi për korrupsion nga dikush që është i fuqishëm dhe që pengon zbardhjen e krimit në Polici.

Ministri Pajaziti nuk ishte prezent në seancë.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtoi pyetje për ministren **Justina Shiroka –Pula** lidhur me shkyçjet kolektive të rrymës që po ndodhin në Kosovë.

Ministrja Shiroka –Pula iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti **Xhevdet Neziraj** parashtoi pyetje për kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me kryerjen e detyrave nga ana e Zyrës për Komunitete në kuadër të Qeverisë dhe pjesëtarët e cilave komunitete janë të punësuar në atë zyrë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Neziraj.

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me gjendjen e vendosjes së institucioneve publike nga objektet e sektorit privat në ato shtetërore.

Pyetjes së deputetit Smaka iu përgjigj ministri i linjës, Arsim Bajrami.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** parashtoi pyetje për ministren **Nekibe Kelmendi** lidhur me procedurat e mbrojtjes shëndetësore të personave me të meta mentale në burgje.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja **Luljeta Shehu** parashtoi pyetje për ministrin **Nenad Rashiq** lidhur me rritjen e asistencës sociale për familjet që kanë anëtarë të zhdukur.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

Deputeti **Bahri Hyseni** parashtoi pyetje për ministrin **Ahmet Shala** lidhur me mos pagesat e pagave të punëtorëve të kombinatit të drurit “Tefik Çanga” në Ferizaj, nga viti 2003-2005, dhe privatizimin e kësaj ndërmarrjeje.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputeti **Gani Geci** parashtoi pyetje për ministrin **Fatmir Limaj** lidhur me afatin kohor të përfundimit të punimeve në rrugën Skenderaj – Vushtrri.

Ministri Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Geci.

Deputeti **Gani Geci** parashtoi pyetje për ministrin **Fatmir Limaj** lidhur me afatin kohor të përfundimit të punimeve në rrugën Skenderaj – Klinë.

Ministri Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Geci.

Deputetja **Qamile Morina** parashtroi pyetje për kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me vlerën e vaksinave për furnizim për vitet 2009 – 2010 dhe shkakun pse është shtuar vaksina e kombinuar Pentavax që ka vlerën 483.600 euro.

Pyetjes së deputetes Morina iu përgjigj ministri i linjës, Alush Gashi.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative

Kryesuesi ftoi ministrin e administratës publike, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Arsim Bajrami tha se Ligji i deritashëm në fuqi ka qenë i miratuar në vitin 2005, në të cilin janë vërejtur mangësi të caktuara dhe për këtë arsye Ministria që ai drejton ka iniciuar ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji. Ky Projektligj tani harmonizohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me realitetin e ri në Kosovë, tha ai.

Në vazhdim, tha se ndryshimet tjera qëndrojnë në faktin që sigurohet rritja e efikasitetit të procedurës administrative, kurse risi shumë e madhe është e dhëna se parashihet aplikimi online në procedurë administrative.

Ai më tej tha se ka edhe risi të tjera që kanë për bazë konceptin e ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe sa më afër qytetarit. Një tjetër risi, tha ministri, është ndryshimi i procedurës në përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore.

Në fund, ai i ftoi deputetët ta miratojnë, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Melihate Termkolli, , në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliq, si dhe deputetët: Nerxhivane Dauti, Rita Hajzeraj dhe Arsim Bajrami, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë Projektligjit për Avokatin e Popullit

Kryesuesi ftoi ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Nekibe Kelmendi, në fillim tha se ky projektligj ka 6 kapituj me 38 nene. Institucioni i Avokatit të Popullit është formuar me rregulloret e UNMIK-ut nr. 2006/6 dhe nr. 2007/15, por as njëra, as tjetra nuk i kanë eliminuar disa zbrastësira.

Në vazhdim, tha se ministria e Drejtësisë ka identifikuar ato zbrastësira ligjore dhe i ka evituar përmes paraqitjes së këtij projektligji, dispozitat e të cilit janë përpiluar në bashkëpunim me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, ekspertët ndërkombëtar dhe janë në harmoni me legjislacionin e BE-së. Më tej, tha se ky projektligj krijon mekanizëm ligjor për mbikëqyrjen e të drejtave njerëzore dhe siguron qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët. Fuqizimi i rolit të Avokatit të Popullit është në interes të rritjes së të drejtave të përgjithshme të njeriut dhe se për shkeljet e adresuara nga palët, Avokati i Popullit i informon institucionet e Republikës së Kosovës, konstatoi ministrja.

Në fund, ajo i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për Avokatin e Popullit.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Avokatin e Popullit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selvije Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Kolë Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj - Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliq, si dhe deputetët: Melihate Termkolli, Mimoza Ahmetaj, Gjylnaze Sylja, Zylfije Hundozi, Berat Luzha, Naser Rugova, Riza Smaka, Driton Tali, Flora Brovina, Naim Rrustemi, Bujar Dugolli, Danush Ademi dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----8,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Avokatin e Popullit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, si komision i interesuar, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit

Kryesuesi ftoi ministrin e Ekonomisë dhe Financave që në emër të Qeverisë ta prezantojë projektligjin.

Ahmet Shala, në fillim tha se kjo fushë deri më tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2, e cila ka pasur disa të meta të caktuara.

Në vazhdim, tha se më këtë projektligj avancohen format moderne kundër shpëlarjes së parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, dukuri këto të shprehura në vendet në tranzicion, e edhe në Kosovë. Më tej tha se me këtë projektligj parashihet edhe Njësia e Inteligjencës Financiare, e cila do të funksionojë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Për bartjen e kësaj njësie në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave parashihet nënshkrimi i një marrëveshje me EULEX-in, konstatoi ai.

Projektligji ka 9 kapituj me 40 nene dhe është i harmonizuar me partnerët ndërkombëtarë të fushës përkatëse, tha ai.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Zylfi Mergja, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Branislav Gërbiq, si dhe deputetët: Edita Tahiri, Gjylnaze Sylja, Sabri Hamiti, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nerxhivane Dauti, Myrvete Pantina dhe Riza Smaka, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,

Kundër-----0,

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projektligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ose raportuesin e komisionit, që në emër të propozuesit ta prezantojë projektligjin.

Deputeti **Armend Zemaj**, në fillim tha se me ndryshimet e propozuara në Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar synojmë eliminimin e disa lëshimeve të karakterit teknik, të cilat megjithatë ndikojnë në zbatimin e këtij ligji. Ai përmendi paragrafin 2.3 dhe 4 të nenit 64, si dhe në vend të fjalisë: “1 janar 2010” të zëvendësohet fjalia: “1 korrik 2010”, e cila paraqet kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në vazhdim, tha se këto ndryshime kanë parasysh faktin e hartimit të akteve nënligjore të cilat dalin nga ky ligj.

Në fund, tha se pikëpamjet e paraqitura për këtë projektligj i paraqet edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Enis Kervan, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Ardian Gjini, ministri Ahmet Shala, Sabri Hamiti, Besa Gaxherri dhe Berim Ramosaj, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe

Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën e kërkoi deputeti Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Sabri Hamiti propozoi që për këtë pikë të rendit të ditës të mbahet seancë e veçantë.

Propozimi u përkrah nga kryetarët e të gjitha grupeve parlamentare.

Propozimin e deputetit Sabri Hamiti e përkrahën të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari konstatoi se seanca plenare për këtë pikë të rendit të ditës do të mbahet me datë 18 mars 2010, në orën 10:00.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi ose raportuesin e komisionit, që në emër të propozuesit ta arsyetojë rekomandimin.

Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi arsyetoi Raportin me rekomandime për emërimin e Adem Vokshit në Komisionin për Kërkesa Pronësore, edhe për një mandat të ri.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryetari e hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

1. Adem Vokshi, emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.
2. Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore zgjat një (1) vit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 17:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale